

**1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2022**

**1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit në sistemin bankar**

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë<sup>1</sup>) Burimi: Banka e Shqipërisë.

| <b>DATA</b>          | <b>R/REPO njëditore</b> | <b>R/REPO njëjavore</b> | <b>R/REPO &gt;1javë &lt;3muaj</b> | <b>REPO Njëditore</b> | <b>Totali i likuiditetit të injektuar</b> |  |
|----------------------|-------------------------|-------------------------|-----------------------------------|-----------------------|---|--|
| <b>6-tetor-22</b>    |                         | 25.35                   |                                   |                       | 44.60                                     |  |
| <b>13-tetor-22</b>   |                         | 16.46                   |                                   |                       | 35.71                                     |  |
| <b>20-tetor-22</b>   |                         | 18.48                   |                                   |                       | 37.72                                     |  |
| <b>24-tetor-22</b>   |                         |                         | 4.94                              |                       | 36.51                                     |  |
| <b>27-tetor-22</b>   |                         | 26.34                   |                                   |                       | 44.37                                     |  |
| <b>3-nëntor-22</b>   |                         | 21.77                   |                                   |                       | 39.80                                     |  |
| <b>10-nëntor-22</b>  |                         | 18.83                   |                                   |                       | 36.86                                     |  |
| <b>17-nëntor-22</b>  |                         | 25.32                   |                                   |                       | 43.35                                     |  |
| <b>24-nëntor-22</b>  |                         | 30.27                   | 4.29                              |                       | 46.33                                     |  |
| <b>1-dhjetor-22</b>  |                         | 34.04                   |                                   |                       | 50.10                                     |  |
| <b>9-dhjetor-22</b>  |                         | 23.96                   |                                   |                       | 40.02                                     |  |
| <b>15-dhjetor-22</b> |                         | 37.23                   |                                   |                       | 53.29                                     |  |
| <b>22-dhjetor-22</b> |                         | 41.02                   |                                   |                       | 57.08                                     |  |
| <b>27-dhjetor-22</b> |                         |                         | 6.52                              |                       | 56.78                                     |  |
| <b>29-dhjetor-22</b> |                         | 35.29                   |                                   |                       | 51.05                                     |  |


Në tremujorin e katërt të vitit 2022, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti. Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë ka vijuar të rritet në 44.60 miliardë lekë kundrejt 43.9 miliardë lekëve mesatarisht në 6 muajt e mëparshëm. Mungesa mesatare ditore e likuiditetit gjatë 3-mujorit ka qenë 8.30 miliardë lekë më e lartë se mungesa mesatare e 5 viteve të fundit prej 36.30 miliardë lekësh.

<sup>1</sup> Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Mungesa e likuiditetit ka pasur prirje rënëse deri në mesin e muajit nëntor prej 47 miliardë lekësh në 35.70 miliardë lekë, kryesisht për shkak të efektit të llogarisë së MFE-së me shpenzime më të larta se të ardhurat, si dhe mosplotësimit të disa ankandeve në tregun primar të letrave me vlerë. Në pjesën e dytë të periudhës, mungesa është rritur shpejt, për t'u stabilizuar në 2 javët e fundit në mbi 50 miliardë lekë. Akumulimi i likuiditetit në llogarinë e MFE-së me rreth 23 miliardë lekë në periudhën 13 nëntor – 22 dhjetor dhe rritja e parasë në qarkullim me 9 miliardë lekë në muajin dhjetor, kanë qenë faktorët kryesorë të rritjes së mungesës, ndërsa rritja e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë me 3.2 miliardë lekë dhe injektimet e përhershme të likuiditetit nëpërmjet blerjeve të valutës nga tregu valutor për 5.3 miliardë lekë e kanë zbutur këtë efekt.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 27.05 miliardë lekë ose 60.65%, kundrejt 55.4% në 3-mujorin e mëparshëm. Injektimet 3-mujore janë ulur gradualisht çdo muaj nga 19.25 miliardë lekë në 15.76 miliardë lekë në parapritje të rënies së mungesës në fillim të vitit 2023.

**Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë.**



## **1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme**


Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës njëditore në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 9.94 miliardë lekë, shifër e ngjashme me atë të tremujorit të mëparshëm dhe me rritje prej mesatares së 6 muajve të parë të vitit prej 8.09 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 9 raste për maksimalisht 2.2 miliardë lekë kundrejt vetëm 1 rasti gjatë 3-mujorit të tretë dhe 5 rasteve për shumat 30-450 milionë lekë në 3-mujorin e parë të vitit 2022.

## **1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë**

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2022, portofoli i Bankës së Shqipërisë është rritur me 3.2 miliardë lekë pas rritjes me 600 milionë lekë në 9 muajt e parë të vitit. Në fund të periudhës, vlera e portofolit është 69.40 miliardë lekë, kundrejt 65.60 miliardë lekëve në fund të vitit 2021.

**Grafik 2: Portofoli i Bankës së Shqipërisë (në mld lekë). Burimi: Banka e Shqipërisë**



## **1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese**

Gjatë periudhës ka pasur dy operacione rregulluese për injektim likuiditeti në datat 19 dhe 20 dhjetor.

## **2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2022**

### **2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë**

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2022, sikurse lajmëruar më 21 dhjetor 2021, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar 4 ankande për blerjen e valutës. Në total gjatë vitit 2022, u blenë 142.24 milionë Euro.

## **Kalendari i ndërhyrjeve në treg**

### **Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2022**

|           | <b>Data</b> | <b>Shuma Raundi I (në euro)</b> |
|-----------|-------------|---------------------------------|
| <b>1</b>  | 18/02/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>2</b>  | 17/03/2022  | <b>anuluar</b>                  |
| <b>3</b>  | 13/04/2022  | <b>anuluar</b>                  |
| <b>4</b>  | 27/04/2022  | <b>anuluar</b>                  |
| <b>5</b>  | 13/05/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>6</b>  | 03/06/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>7</b>  | 17/06/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>8</b>  | 12/07/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>9</b>  | 22/07/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>10</b> | 05/08/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>11</b> | 19/08/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>12</b> | 18/10/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>13</b> | 18/11/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>14</b> | 05/12/2022  | 5-8 mln                         |
| <b>15</b> | 16/12/2022  | 5-8 mln                         |

**Shënim: Me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 140-200 milionë Eur gjatë vitit 2022.**

Në fund të muajit dhjetor 2022, KZKPM miratoi shumën në euro për t'u blerë gjatë vitit 2023 dhe ndryshimin e vendimit për blerjet e vitit 2022. Në përputhje me këto vendime, në datën 13 dhjetor u shpall kalendari i blerjeve të vitit 2023 sipas skedulit të mëposhtëm.

## Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2023

| Data          | Shuma Raundi I (në euro) |
|---------------|--------------------------|
| 1 17/02/2023  | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 2 17/03/2023  | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 3 11/04/2023  | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 4 20/04/2023  | 35-9 mln                 |
| 5 11/05/2023  | 35-9 mln                 |
| 6 26/05/2023  | 35-9 mln                 |
| 7 09/06/2023  | 35-9 mln                 |
| 8 21/06/2023  | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 9 06/07/2023  | 35-9 mln                 |
| 10 20/07/2023 | 35-9 mln                 |
| 11 04/08/2023 | 35-9 mln                 |
| 12 18/08/2023 | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 13 18/10/2023 | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 14 17/11/2023 | 35-9 mln (1 mo FW)       |
| 15 06/12/2023 | 35-9 mln                 |
| 16 20/12/2023 | 35-9 mln (1 mo FW)       |

**Shënim:** Me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 125-145 milionë Euro gjatë vitit 2022.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 160-220 milionë Euro.

**\* Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.**

Në këtë lajmërim, janë publikuar jo vetëm datat e ankandeve dhe shumat përkatëse, por edhe ato ankande në të cilat, do të përdoret opsioni forward.

### **2.2 Veprime me institucione të tjera**

Gjatë tremujorit të katërt, MFE ka maturuar marrëveshjen SWAP për 40 milionë Euro në datën 30 nëntor, ndërsa në ditët e fundit të vitit, ka rinovuar marrëveshjet ekzistuese, si dhe ka dakordësuar marrëveshje të reja, duke e çuar totalin e marrëveshjeve SWAP pranë limitit maksimal prej 25 miliardë lekësh. Marrëveshjet SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 79 mil Euro në 16 mars 2023
2. 50 mil Euro në 17 prill 2023
3. 40 mil Euro në 20 tetor 2023

4. 45 mil Euro në 17 nëntor 2023

Gjatë 3-mujorit, Banka e Shqipërisë ka blerë 6.35 milionë Euro nga programi IPA i MFE dhe 3.75 mil Euro nga IBRD.